



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Tiranë, më 17.03.2020

### NJOFTIM

#### “PËR NGRITJEN NË DETYRË NË KLSH”

Në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr. 152/2013, datë 01.10.2013 “Për Nëpunësin Civil”, si dhe Vendimin nr. 4, datë 27.01.2017 të Kryetarit të KLSH “Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar;

#### **Ju njoftojmë se:**

Kanë filluar procedurat për ngritje në detyrë për:

#### **I. Për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.**

Në konkurrim ftohen të marrin pjesë audituesit që plotësojnë këto kritere:

- të kenë eksperiencë pune në KLSH
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë rezultate pozitive në auditime;
- të kenë dhënë kontribut në botime të ndryshme në KLSH, artikuj në gazeta e revista (përkthime) të ndryshme etj.

#### **II. Për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Metodologjisë dhe Zhvillimit.**

Në konkurrim ftohen të marrin pjesë audituesit që plotësojnë këto kritere:

- të kenë eksperiencë pune në KLSH
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë rezultate pozitive në auditime;
- të kenë dhënë kontribut në botime të ndryshme në KLSH, artikuj në gazeta e revista (përkthime) të ndryshme etj

Të gjithë të interesuarit duket të paraqesin kërkesën e tyre pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore deri më **datë 31 Mars 2020**

*Kërkesa duhet të shoqërohet me një prezantim të performancës gjatë kryerjes së veprimtarisë audituese dhe detyrave funksionale si dhe paraqitjen e një projekti mbi drejtimin e një drejtorie.*

Testimi për ngritje në detyrë do të zhvillohet bazuar në vlerësimin e performancës, vlerësimin e dosjeve individuale, si dhe intervista e strukturuar me gojë nga Komiteti i Pranimit Për Ngritjen në Detyrë.

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**